



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.405/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidatës për anëtare të Komunës së Prishtinës, Vjollca Mjekiqi-Sallova, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, paraqitur për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e parashtruar nga kandidatja për anëtare të Komunës së Prishtinës, Vjollca Mjekiqi-Sallova, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, me shenjën ZL.A.nr.405/2017 e datë 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga kandidatja për anëtare të Komunës së Prishtinës, Vjollca Mjekiqi-Sallova, nga radhët e subjektit politik LVV, dega në Obiliq, me të cilën ka pretenduar se në Qendrat e Votimit në Milloshevë nr. 1502e/01R, 1502e/02R, 1502e/03D dhe Qendrat e Votimit në Mazgit të Ulët nr. 1520e/01R, 1520e/02D, numëri i votave nuk është i përputhshëm në bazë të informatave të votuesve, të cilët deklaruan votën e tyre për kandidaten Vjollca Mjekiqi-Sallova. Më tej ka pretenduar se numërimi nuk është i sakt.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli, nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesë sepse, pretendimet ankimore që ndërlihen me rezultatin e votimit duhet të parashtrohen me rastin e publikimit të shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës.

Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja

e ankesës së ankueses Vjollca Mjekiqi-Sallova, nuk e paragjykon çështjen dhe ankueses nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesë, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.405/2017 më datën 24.10.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.